



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/03-9465/2018  
Kaçanik, 30.03.2018

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e III (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 30 Mars 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsyen. Pranverë Loku-Zharku ( pati rast vdekje në familje).

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Nënkyetari i Komunës – Ylber Bajra, drejtoret e drejtive komunale: Bahri Selimi, Fatmir Loku, Festim Neziraj, Zahir Doda, Ukshin Qallaku dhe Ramadush Osmani.

Në Mbledhje mori pjesë, asistentja e Kryesuesit të KK, Kaltrina Luma.

Mbledhja u monitorua përmes Tel-prezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të KK në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi ekziston me u mbajtur mbledhja, kushte pune ka, andaj e hapi mbledhjen e III (Tretë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data 30 Mars 2018, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Prosesverbalit nga mbledhja e II (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2017;
3. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017;
4. Propozim Vendimi për iniciimin e procedurës dhe formimin e Komisionit për Ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut;
5. Propozim Vendimi për iniciimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit të Kaçanikut, si institucion me status publik;
6. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Propozim Vendimi për marrjen e Vendimit Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrave Nr. 01436-0, Arë e Kasës së 3, në emër të Adem S. Luma;

8. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrave Nr. 600-2, tokë pyjore- Mal i klasës së 2 (Dytë), Zona Kadastrave Bajnicë, në pronësi të " Green Hill" Sh.P.K;
9. Informatë për dëmet e shkaktuara nga të reshurat e shiut;
10. Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2018; dhe
11. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materiali për pikët, 10 dhe 11 iu është dërguar me vonë, kur dihet fakti se këto dy trupa punuese janë formuar me vonë dhe nuk ka pasur hapësirë për me i hartuar me herët Planet e tyre të punës. Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin:

**z. Shpend Krusha dhe z. Bekim Koxha,** Kërkuan që Procesverbali i mbledhjes anëtarëve të KK t'iu dërgohet së bashku me materialin e mbledhjes.

**z. Adnan Reka,** Ne e aprovuam Procesverbalin e mbledhjes se kaluar me zotim se do të futën vërejtjet të cilat i paraqitëm, ndërkundje Procesverbali me përmirësimë nuk na është përcjellë e as nuk është publikuar në Faqen Zyrtare të Komunës.

**z. Ekrem Raka,** Sugjeroj që në Procesverbal të shënohen: Propozimet. Vërejtjet dhe Sugjerimet, ndërkundje pjesën tjeter e marrim nga incizimi i mbledhjes, sepse në të kundërtën procesverbali del i mangët, sepse është e pamundur të përfshihet në proces çdo gjë që diskutohet në mbledhje.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka tjetër, Rendin e Punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprova njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e ,

#### APROVOJ

Rendin e Punës në Përbërje 11 pikave..

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e II (Dytë ) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së II-r (Dytë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës u miratuar njëzëri pa ndonjë vërejtje eventuale. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

#### APROVOJ

Procesverbalin nga Mbledhja e II (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 28 Shkurt 2018/ Lënda : 01Nr. 60/01-5522/2018.

#### **PYETJE dhe KËRKESA**

**z. Adnan Reka,** Kërkoj që mbledhjet e KK të përcillen live –drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës. Ky është edhe premtim gjatë fushatës zgjedhore, i Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi, se ka me pasur transparencë dhe llogaridhënie, nëse e merr mandatin.

**z. Arlinda Raka-Rakoci,** Shprehi shqetësimet e saja për punësimë familjare në komunë, me këtë rast e përmendi, Konkursin e hapur për Sekretar shkolle në SHFMU " Emin Duraku " në Kaçanik. Në këtë Konkurs tha se kam aplikuar edhe unë dhe pa asnjë arsyetim me

thuhet se nuk i ke plotësuar kriteret e konkursit. Unë jam nga familja e dëshmorit dhe për kundër faktit se jemi tre fëmijë me kualifikim superior, asnjë nuk jemi të punësuar në institucionet shtetërore.

**z. Bekim Koxha,** Shprehi shqetësimet e tija për çështjen e kanalizimit në f. Koxhaj, i cili është në gjendje të rëndë. ndërkaq kérkoj nga DUKMM me marrë veprime të nevojshme për sanimin e gjendjes së tij.

**z. Hajredin Luta,** Kérkoj të jetë në rend pune çështje; Të Ndryshme, në mënyrë që t'i paraqesim Kérkesat dhe Ankesat tona në atë pikë, ndërkaq paraqiti një shqetësim për mjetet e grumbulluara nga komuniteti për një projekt të fshatit Ivajë, të cilat mjete ia kemi dhënë kryetarit të fshatit dhe nuk e dimë çka u bë me ato mjete.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Pika të Ndryshme nuk do të kemi, ndërkaq mjetet kérkonati ku i keni dërguar. Meqë nuk ka Kérkesa të tjera, përgjigjet do t'i merrni në mbledhjet vijuese nga shërbime përkatëse, ndërkaq konstatoj të procedojmë me pikët tjera të radhës.

## 2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2017:

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për këtë pikë fjalën ia jap drejtorit të DEFZH, Bahri Selimi, pasi që Kryetari i Komunës nuk është këtu, ndërkaq nënkyetari i komunës nuk ka qenë pjesë e qeverisë në vitin 2017.

**z. Bahri Selimi,** E shpalosi Raportin e Ekzekutivit të Komunës për vitin 2017, duke potencuar aktivitetet-të arriturat e komunës në të gjithë sektorët dhe vështirësitë që janë përballur për gjatë një viti. Në vazhdim i përmendi të arriturat në realizimin e projekteve e 20 projekteve kapitale, projektet e bashkë - financuara nga HELVETAS në kuadër të programit DEMOS, implementimi i projekteve nga niveli qendror ( në rrugë, ujësjellës, kanalizim) , projekte shëndetësore, projektet shkollore etj. të paraqitura si në faqen 1 të Raportit. Në vazhdim përmendi ekzekutimin e buxhetit të shpenzuara nga GQ 99.60% apo 6,119.685€ dhe inkasimin e mjeteve në të HVK 75% e tyre nga ato të planifikuara prej 861 mijë euro.

**Kryesuesi i Kuvendit,** I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Ne si LVV asnjë nga anëtarët e KK nuk kemi qenë pjesë e KK në mandatin e kaluar. Nga Raporti shihet se ka të arritura, por edhe mangësi. Nëse i referohemi nenit 17 të LVL, zhvillimit ekonomik lokal, nuk mund të themi se ka zhvillim, kur dihet se 50% e bizneseve janë mbyllur, pastaj nuk ka punësime etj. Të Sektori i bujqësisë, ka grante, por nuk janë të mjaftueshme.

Rruga "Mejdi Dalloshi" është shtruar para 5 muajve, por e njëjta është duke u shkatërruar. Në gjendje jo të mirë është edhe kanalizimi në atë pjesë. Të Sektori i Arsimit, numri i mungesave të nxënësve dhe arsimtarëve nuk ka rënë. Të Shëndetësia, shërbime ka me tepër në ordinanca private, sesa në QKMF. Në Sektorin e Sportit, nuk mund të themi se nuk ka të arritura, ndërkaq të Kultura, SHKA, kanë veshje jo të mirë për me dhënë vlera tradicionale.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Raporti përmban të gjitha aktivitetet e ekzekutivit të komunës për gjatë një viti, ndërkaq për mungesat është në obligim ligjor i drejtorisë në fund të vitit me i pasur të gjitha evidencat e shkollave.

**znj. Fatijona Kyçyku,** Të trajtimi i qenve endacak, nuk e keni cekur në Raport se çfarë trajtimi i cili iu është bërë dhe cila kompani e ka bërë trajtimin e tyre. Në këtë projekt, si duket nuk ka transparencë te mjaftueshme.

**z. Selim Reka,** Është për t'u përshëndetur realizimi i buxhetit në përqindje mbi 99.60% dhe realizimi i tri projekteve të finançuara nga MTI në vitin 2017.

Të DSHMS, sektori për Mirëqene Sociale, nuk dihet numri i të rinjve të prekur nga narkomania. Me intereson të di cili është roli i QPS në këtë rast. Me pas shifrat, besoj se edhe ne kishim mundur me ndihmuar në këtë drejtim.

Të sektori i Inspektoratet, janë tri raste që janë shqiptuar gjoba për pirje të duhanit, ndërkaq dihet se Ligji për ndalimin e pirjes se duhanit në lokale nuk po zbatohet sa duhet.

Të Inspektorati sanitari, janë marrë vetëm tri mostra gjatë një viti, me çka kujtoj se nuk mjaftojnë.

Të Shërbime publike, ka shumë rrugë që janë kryer, por ka pasur lëshime në këtë drejtim, sepse nuk janë bërë anësorët ose nuk janë shfrytëzuar mjetet, kështu që dëmet janë evidente.

Të Mirëmbajtja e rrugëve: Rruga "Avduhhahim Shehu" nuk është bërë asgjë. Ka edhe rrugë tjera në qendër të qytetit si dhe shtrati i lumbit Neredime të cilat kanë nevojë për rehabilitim.

Të ujësjellësi, ka lagje të cilat janë jashtë ujësjellësit dhe nuk ka ndonjë plan për to. Të Trajtimi i ujërave të zeza, është bërë diçka në këtë segment, por ende ka nevojë me intervenuar. Të menaxhimi i mbeturinave, shportat janë shpërndarë, ndërkaq mbeturina ka kudo. Komuna duhet marrë veprime që hedhësit e mbeturinave vend e pavend me u denoncuar. Të ndriçimi, është bërë diçka në këtë drejtim por ende ka nevojë me intervenuar, sepse ka rrugë ku shtyllat elektrike kanë mbetur në trotuar. Ndriçim elektrik, duhet me pasur edhe rruga "Avdurrahim Shehu" sepse ka rrezik nga qenët endacak. Të Sektori i pylltarisë nuk ka mbrojtje, por shkatërrim të pyjeve.

**z. Nexhat Loku,** Është për t'u përshëndetur realizimi i buxhetit të komunës me 99. 60%, kështu duke u nisur nga ky realizim, shihet se janë kryer shumë aktivitete të komunës të parapara me Planin e punës së vitit 2017, andaj në emër të grupit parlamentar të PDK e kemi vlerësuar këtë Raport pune me shumë të arritura dhe e mbështetim.

**z. Bekim Koxha,** Theksoj se buxheti i vitit 2017 nuk është shfrytëzuar në formë të drejtë në Bujqësi dhe Blegtori, sepse subvencionet kanë qenë të vogla dhe jo të mjaftueshme për këtë sektor. Mundësi me u zhvilluar sektori i kafshëve të egra ka, andaj ekzekutivi i komunës duhet të merr iniciativa për krijimin e infrastrukturës - ndërtimin e rrugëve të Stanet, për zhvillimin e këtij sektori. Sektori i Shëndetësisë, është ndërtuar QMF në Kaçanik të Vjetër, e cila nuk i përfshinë të gjitha fshatrat.

**z. Ramadush Osmani,** Jep sqarime në pyetjen e Fatijona Kyçyku. Kompania për trajtimin e qenve endacak është përgjedhë përmes procedurës së Prokurimit, kompania është nga Ferizaj, është e licencuar, ndërkaq emrin nuk ia di.

**Kryesuesi i Kuvendit,** çështja e qenve endacak është problem në gjithë Kosovën. Qentë duhet me i nxënë dhe me i vendosë në rrethojë dhe me i trajtuar. Ende për këtë problem nuk ka formulë të qartë në Kosovë.

**z. Adnan Reka,** Është mirë me ditur Kontratën për trajtimin e qenve endacak, sepse nëse mjetet janë shpenzuar për realizimin e këtij projekti, ndërkaq ne nuk e dimë si janë trajtuar qentë endacak, kjo nuk është në rregull.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Informata e hollësishme për çështjen e qenve endacak, mund t'i merrni në, Zyrën e Prokurimit. Meqë nuk ka diskutime të tjera, Raporti nuk votohet në të gjitha komunat. Megjithëse unë këtë herë po e shtroj në votim Raportin, ndërkaq për hera të tjera do ta rregullojmë këtë çështje. Rezultati i votimit ishte, 16 votë Për, Kundër 6 anëtarë, Abstenuan 4. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Raportit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2017.**

**3.** Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017;

**Kryesuesi i Kuvendit.** Për këtë pikë fjalën e ka drejtori, Bahri Selimi.

**z. Bahri Selimi,** E shpalosi buxhetin e miratuar dhe të realizuar, i potencoj në detaje shpenzimet e realizuara për gjatë një viti buxhetor në të gjitha programet shpenzuese buxhetore, pozicionin ku kemi pasur ngritje të shpenzimeve apo ulje të tyre. Sqaroj edhe për Projekte e realizuara dhe ato që janë në realizim e sipër, Të HVK në të gjithë sektorët, i dha me shifra aty ku janë inkasuar me të tepër dhe ku ka ngecje të tyre, ashtu si janë paraqitur në tabelat e Raportit financiar.

**Kryesuesi i Kuvendit.** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçiku,** Të taksat nga ushtrimi i veprimtarisë në disa sektor ka shumë mangësi. Edhe të telefonia fikse, shihet se janë ngritur shpenzimet.

**z. Ekrem Raka,** Parashtroj pyetje të detyrimet kontingjente, f. 25, a janë shlyer këto detyrime apo kanë mbetur ende borgje.

**z. Bahri Selimi,** Të Telefonia fikse ka të bëjë me atë sesi janë paguar faturat. Të rrugët lokale, janë të specifikuara në raportin e ekzekutivit të komunës. Të hartimi i projekteve është për angazhimin e disa zyrave përkatëse në mungesë të burimeve të mjaftueshme njerëzore, kjo me ligj lejohet. Të shkollat, janë në raport se në cilat shkolla është intervenuar, si është intervenuar të nxehja etj. Të HVK në vitin 2018, kemi ngritje të tyre në disa sektor e në disa ka ulje, si të tatimi në pronë, si rezultat i faljes së borgjeve në vitin 2016. Të Detyrimet kontingjente nuk janë borgje, por janë detyrime të cilat mund të ndodhin. Shumat e parapara, është menduar se mund të ndodhë me vendime të Gjykatës të rasti Tusha. Disa raste janë paguar në bazë të vendimeve të gjykatave e disa jo. Shumat me të mëdha të detyrimeve kontingjente janë për pronat.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë Raport financiar e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 5, Abstenuan 6. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për aprovimin e Raportit Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017**

**4.** Propozim Vendimi për iniciimin e procedurës dhe formimin e Komisionit për Ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kjo çështje është miratuar edhe në KPF. Nevojë me u ndërruar Statuti i Komunës ka, sepse jemi e vëmja komunë që funksionojmë me pak drejtori. Ka nevojë të ndahet sektori i Kulturës nga drejtoria e Arsimit, dhe disa ndryshime të tjera ku e shohim të nevojshëm dhe të arsyeshëm për një funksionim me të mirë të komunës. Nëse ka kush diçka, për këtë pikë e hapi diskutimin;

**z. Ekrem Raka,** Fillimisht duhet të iniciohet procedura e Ndryshim Plotësimit të Statutit të Komunës e pastaj të formohet Komisioni për me punuar në ndryshimet e Statutit.

**z. Shpend Krusha,** A duhet të votojmë secilin nen veç e veç apo si tërësi ndryshimet dhe plotësimet në Statutin e Komunës.

**z. Ekrem Kyçyku,** Ne jemi për atë që çdo nen e paragraf të votohet veç e veç, ndërkaq ne LVV kërkojmë me na dhënë pak minuta pauzë për konsultime.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ndryshimet e Statutit bëhen ashtu si vendos KK, është mirë veç e veç me u votuar secili ndryshim që bëhet. Në vazhdim lejoj kuvendit për një pauzë 10 minuta.

Pasi pasues për konsultim të KK, u vazhdua me mbledhjen, Kryesuesi i Kuvendit theksoj se jemi për atë që fillimisht të iniciohet Procedura e ndryshim plotësimit të Statutit të komunës, pastaj të formohet komisioni për me punuar rrëth ndryshimeve të Statutit. Pra vendimin e ndajmë në dy vendime. Atëherë, propozimin e z. Ekrem Raka e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u miratua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës pikën 4 vendosi të ndajë në dy pikë.

**4.1.** Propozim Vendimi për iniciimin e procedurës për Ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit,** A jeni të pajtimit për iniciimin e procedurës së Ndryshim Plotësimit të Statutit të Komunës. Meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u miratua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Iniciimin e procedurës për Ndryshim Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut.**

**4.2.** Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për Ndryshim Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Formimi i Komisionit për Ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës do të jetë 7 anëtarë, 4 nga Kuvendi i Komunës, 2 nga Ekzekutivi dhe 1 nga OJQ. A jeni për atë që Komisioni të jetë në këtë përbërje; Nëse nuk ka kush diçka atëherë përbërjen e komisionit prej 7 anëtarëve e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit është: shumica votuan Për, Kundër ishte 1 (Arlinda Rakoci-Raka), Abstenuan 3. Në saje të kësaj del konstatimi se KK vendosi që përbërja e Komisionit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës të jetë 7 anëtarë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në vazhdim, kërkojë me i dhënë propozime konkrete, duke filluar nga subjektet politike me të mëdha, për anëtarë të komisionit;

- z. **Nexhat Loku**, Nga PDK e propozojmë pér anëtar të komisionit, Besim Vishi,
- z. **Ekrem Kyçyku**, Nga LVV e propozojmë pér anëtar të komisionit, Shpend Krusha,
- z. **Selim Reka**, Nga LDK e propozojmë pér anëtar të komisionit, Arlinda Rakoci-Raka,
- z. **Albana Troni**, Nga AAK e propozojmë pér anëtar të komisionit, Shemsedin Luzha, Nënkyryetari i Komunës, Ylber Bajra, Nga Ekzekutivi i Komunës, propozojmë; Festim Neziraj dhe Ilir Lumi, ndërkaq nga OJQ, Burim Çaka, nëse ka të drejtë, nëse jo atëherë hiqet, pér t'u zëvendësuar më ndonjë anëtar tjetër nga OJQ.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Meqë nuk ka kush diçka, atëherë propozimet të cilat dolën i shtroj në votim pér aprovim dhe të njëjtat u aprovuan me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 4. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Formimin e Komisionit pér Ndryshim Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut, me këtë përbërje;**

- |                               |                           |
|-------------------------------|---------------------------|
| 1. <b>Besim Vishi</b>         | anëtar i KK nga PDK;      |
| 2. <b>Shpend Krusha</b>       | anëtar i KK nga LVV;      |
| 3. <b>Arlinda Rakoci-Raka</b> | anëtare e KK nga LDK ;    |
| 4. <b>Shemsedin Luzha</b>     | anëtar i KK nga AAK;      |
| 5. <b>Festim Neziraj</b>      | drejtor i DAP ;           |
| 6. <b>Ilir Lumi</b>           | Zyrtar Ligjor i Komunës ; |
| 7. <b>Daut Rudi</b>           | ekspert (avokat) nga OJQ. |

5. Propozim Vendimi pér iniciimin e procedurave pér themelimin e Teatrit të Qytetit të Kaçanikut, si institucion me status publik;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Për sqarime të nevojshme në këtë pikë, fjalën ia jap drejtorit të DAK, Zahir Doda.

z. **Zahir Doda**, Kërkesa është nga një grup iniciues. Ekziston Rregullorja e cila saktë e e definon themelimin e teatrove të qytetit. Në rregullore përshkruhen kushtet dhe kriteret, vendimin kush e aprovon etj. Si komunë ne i plotësojmë kushtet minimale me pasur teatër, objekti ekzisto-shtëpia e kulturës, pastaj duhet me ditur pér buxhetin etj. Para se të merr vendim KK, duhet një Pëlqim nga Komisioni pér themelimin e teatrove. Unë sot kërkoj nga KK dritën e gjelbër pér këtë projekt. Unë do të filloj procedurat me ndihmën e grupit iniciues. Vendimi përfundimtar nuk mund të merret pa u krye të gjitha obligimet lidhur me këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit**, E njoftoj KK lidhur me iniciimin e çështjes nga një grup iniciues, veprimet të cilat janë marrë deri sa ka ardhur kjo çështje në KK me çka theksoj se e kam pasur një takim me këtë grup ku ka marrë pjesë edhe drejtori i DAK. Sot do të bëhet vetëm iniciimi i procedurës, pastaj nëse plotësohen të gjitha kushtet, vendimin përsëri e merr KK.

z. **Ekrem Kyçyku**, Është iniciativë e mirë e cila është marrë nga grupi iniciues. Kaçaniku kohë me parë ka pasur teatër, shpresoj kjo iniciativë të realizohet tanë, ndërkaq unë kërkoj nga ekzekutivi i komunës të shqyrtoj mundësitet buxhetore pér teatër.

**znj. Kaltrina Tafili**, Me vjen shumë mirë që e keni marr në konsideratë Kërkesën e grupit të artistëve vendas pér themelimin e Teatrit të Qytetit, të cilëve me këtë rast, u shprehi

falënderime të sinqerta të gjithëve, e në veçanti e falënderoj regjisoren e mirënjoj Ben Apolloni, i cili po bartë barrën kryesore të kësaj nisme. Themelimi i Teatrit të Qytetit sot, do të jetë një ngjarje shumë e rëndësishme kulturore dhe shumë e nevojshme shoqërore për qytetarët dhe komunën tonë. Kjo për arsy se, siç dihet, Kaçanikut i ka munguar thuajse plotësisht jeta e mirëfilltë kulturore dhe aktivitetet e nevojshme artistike, për kaq shumë vite, ndërkaq dihet se Kaçaniku ka shumë artistë: aktorë, regjisori, shkrimtarë, dramaturgë, madje shumë të shqar. Prandaj ne sot, për të gjitha këto që i thash, dhe për të tjera të ngjashme, do e votojmë PËR këtë Propozim-Vendim për themelimin e Teatrit të Qytetit në Kaçanik, të cilin projekt ne si Lëvizje Vetëvendosje e kishim edhe në Programin tonë qeverisës, duke kërkuar njëkohësisht që ky vendim, pas votimit në këtë kuvend, të mos mbetet vetëm në letër, por të realizohet pa vonesa të panevojshme, e në këtë mënyrë të hapet mundësia që edhe Kaçaniku ynë ta pasuroj jetën shoqërore, ta kthej imazhin e qytetit të kulturës, e të prodhoj kështu lajme të mira.

**z. Adnan Reka,** Edhe unë shprehi kënaqësi që u mor në konsideratë kjo çështje për t'u venë në rend pune, kur dihet rëndësia që ka themelimi i Teatrit të qytetit, i cili projekt ka qenë nevojë dhe domosdoshmëri e kamotshme për Kaçanikun. Historia, Kultura dhe tradita e qytetit tonë mund të shprehet më së miri përmes teatrit dhe artistëve. Në vazhdim z. Reka e theksoj një mendim të një mendimtar kinez” Nëse doni të shihni nivelin e civilizimit të një shoqërie, shikoja varrezat dhe teatrin”.

**z. Zahir Doda,** Nuk mendoj se është kush kundër, ndërkaq duhet me u ditur punët që duhet me u kryer për çështjen e realizimit të këtij projekti. Shumë lehtë është me kërkuar, por çështja e realizimit është tjeter. Unë kam me kërkuar ndihmën e tyre, objekti ekziston, staf drejtues duhet të jetë 10 anëtar rezident. Krejt problemi varet nga ministria e Kulturës. Nëse Beni me ndihmon, unë do të ia lë barrën kryesore.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Foli për procedurat e zhvilluara deri sa ka ardhur çështja në KK.

**Nexhat Loku,** E jona është me na përkrah me arritur deri të realizimi i këtij projekti. Ne do të angazhohemi të gjithë me ia kthyer Kaçanikut këtë projekt.

**z. Bekim Koxha,** E përgëzoj grupin iniciues të projekteve, ne do ta përkrahim, ndërkaq shpresojmë në realizimin e tij.

**z. Shpend Krusha,** Deponimi i të gjithë anëtarëve të KK shihet se është për aprovimin e këtij projekti. Nga diskutimi, u kuptua se duhet me lobuar për këtë projekt. Ne si LVV do t'i shfrytëzojmë në këtë kuptim të gjitha mundësitë tona.

**z. Selim Reka,** Në emër të subjekti politik të LDK konfirmoj se do të mbështetim këtë projekt. Ne iniciativa të tillë e të ngjashme do t'i mbështetim sa herë, ndërkaq duke ditur buxhetin e komunës tonë jam pak skeptik në këtë drejtim.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për iniciimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit të Kaçanikut, si institucion me status publik.

6. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:

**Kryesuesi i Kuvendit,** Komisioni do të ketë përbërje 7 anëtarë. 3 anëtarë do të jenë nga KK, 3 nga Ekzekutivi dhe 1 nga OJQ. Nëse ka kush diçka, për këtë pikë hapi diskutimin; Meqë nuk ka kush për diskutim, atëherë shkojmë me propozime konkrete për anëtar të komisionit.

**z. Nexhat Loku,** Nga Subjekti politik i PDK e propozoj për anëtar të komisionit, Kadri Krivenjeva,

**z. Ekrem Kyçiku,** Nga LVV e propozoj për anëtar të komisionit, Kaltrina Tafili,

**z. Selim Reka,** Nga LDK e propozojmë për anëtar të komisionit, Besnik Salihu,

**Nënkyetari i Komunës,** Nga Ekzekutivi e propozojmë, Hidajete Guri, Remzi Shabani dhe Zylfi Koxha, ndërkaq nga OJQ e propozojmë, Zekirja Elezi, ekspert i kadastrave.

Propozimet që u dhanë u shtruan në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovuan me një votë Abstenim, Bekim Koxha. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me këtë përbërje:

- |                    |                                |
|--------------------|--------------------------------|
| 1.Kadri Krivenjeva | anëtar i KK nga PDK;           |
| 2.Kaltrina Tafili  | anëtar i KK nga LVV;           |
| 3.Besnik Salihu    | anëtar i KK nga LDK ;          |
| 4.Hidajete Guri    | nga Ekzekutivi i Komunës;      |
| 5.Remzi Shabani    | nga Ekzekutivi i Komunës;      |
| 6. Zylfi Koxha     | nga Ekzekutivi i Komunës; dhe  |
| 7. Zekirja Elezi   | nga OJQ, ekspert i kadastrave. |

7. Propozim Vendimi për marrjen e Vendimit Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrave Nr. 01436-0, Arë e Kasës së 3, në emër të Adem S. Luma;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Këtë propozim vendim kemi të bëjmë me marrjen e Vendimit paraprak. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM PARAPRAK**

Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore të parcelës së kadastrave Nr. 01436-0 -tokë bujqësore – Arë e Klasës së 3 (Tretë) në sipërfaqe: 1573m<sup>2</sup>, e evidentuara në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-70917088-01436-0, Zona Kadastrave Gilloboçicë, në pronësi të Adem S. Luma, destinohet në Tokë Ndërtimore.

8. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës së kadastrave Nr. 600-2, tokë pyjore- Mal i klasës së 2 (Dytë), Zona e Kadastrave Bajnicë, në pronësi të “ Green Hill” Sh.P.K;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Edhe të kjo çështje do të merret një vendim paraprak, pastaj në bazë të këtij vendimi del komisioni nga niveli qendror dhe e shqyrton ndërrimin e destinimit. Për këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Raka,** Lëndët të cilat na janë adresuar për ndërrimin e destinimit, a janë bërë në bazë të kërkesave të palës. Nëse drejtoria është kundër miratimit të një kërkesë të tillë, atëherë a duhet me na sjellë çështjen në KK. Nëse DUKMM është Për ndërrimin e destinimit të pronës në fjalë, atëherë edhe unë do të jap Për.

**z. Bekim Koxha,** Me intereson të di se ku gjendet prona në fjalë dhe a i kanë harmonizuar qëndrimet DUKMM dhe DBPZHR.

**z. Ukshin Qallaku,** Prona është në hyrje të Bajnicës, ndërkaq pas marrjes së vendimit lënda shkon në MBPZH dhe nëse ministra e jep Pëlqimin, atëherë kjo çështje del edhe një herë në KK për vendim përfundimtar. Në momentin që DUKMM e bien çështjen në KK, dihet se është për miratim, në të kundërtën e refuzon vet si drejtori.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në momentin që DUKMM e bien çështjen në KK, atëherë dihet se është Për, në të kundërtën ka të drejtë të Refuzon me Vendim të drejtorisë. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 6 Abstenime. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM PARAPRAK**

Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore, në parcelën e kadastrave Nr. 600-2 -tokë bujqësore (pyjore) Mal i Klasës së 2 (Dytë) në sipërfaqe: **997 m<sup>2</sup>**, e evidentuara në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-70917002-01436-0 Zona e Kadastrave, Bajnicë, në pronësi të, "Green Hill" Sh.P.K. destinohet në Tokë Ndërtimore.

**9. Informatë për dëmet e shkaktuara nga të reshurat e shiu;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për sqarime të nevojshme fjalën ia jap drejtorit të DSHPE, Ramadush Osmani.

**z. Ramadush Osmani,** Theksoj se gjatë të reshurave atmosferike në datat e shënuara si në informatë, jemi munduar përmes kompanive kontraktuese me iu dalë në ndihmë qytetarëve. Fond emergjent nuk kemi për raste të tilla. Veprimet të cilat janë marrë janë shënuar në informatë.

**z. Adnan Reka,** Shprehi shqetësimë për situatën e krijuar emergjente dhe mos intervenimin me kohë nga qeveria. Kjo të bënë me kuptuar se qeveria nuk ishte e përgatitur për situata momentale, ndërkaq shtoj se qeveria e kësaj komune e para 50 viteve kishte vizion dhe profesionalizëm, ku pushteti i asaj kohe kishte ndërtuar diga të mëdha, ndërkaq sot qeveria nuk po ka mundësi të ndërtoj diga, por as t'i mirëmbajë ato ekzistuese.

Në gjendje jo të mirë është edhe ujësjellësi i komunës, ku pas çdo reshje atmosferike, ndotet uji i pijes, me çka paraqet rrezik për qytetarët e komunës tonë për përhapjen e ndonjë epidemie. Para disa javësh jemi njoftuar nga DSHPE për drenazhimin e varrezave të qytetit, por nuk e di se a ka në plan drejtoria t'i kanalizoj ujërat atmosferike që lëshohen nga dy rrugë të qytetit dhe derdhën në lumin Neredime, të cilat ujëra për gjatë reshjeve atmosferike krijojnë përrua në mes të qytetit dhe pamundësojnë qarkullimin e qytetarëve. Kjo të bënë me kuptuar me problemet që përballën qytetarët e Kaçanikut të cilët jetojnë në qendër të qytetit, ndërkaq paguajnjë taksa më të larta të tatimit në pronë.

Ka mungesë të planeve të ekspertëve, kjo u bë e ditur në situatat emergjente, ndërkaq edhe pas situatave emergjente mund të krijohen edhe fatkeqësi tjera natyrore, ndërkaq zyrtarët kompetent nuk morën veprime urgjente profesionale për sanimin e gjendjes. Në vazhdim z. Reka foli për zhbllokimin e pjesës kryesore të bulavardit 'Ismail Raka', komentet e qytetarëve të Ura e Rakocit për papërgjegjshmérinë komunës etj. foli për dëme etj. pësuan

edhe banorët e f. Kukaj, ku ishin të izoluar tri ditë, ndërkaq kompania “Bektel Enka” ua hapi rrugën, ndërkaq qeveria nuk mori ndonjë veprim. Pos kritikave, z. Reka dha alternativë, që mjetet financiare të pashpenzuara nga vitet e kaluara të shpenzohen për pastrimin e digave, rregullimin e ujësjellësit dhe mundësitë e fondit për me iu dalë në ndihmë banorëve të prekur, pasi kemi obligim ligjor se janë taksapagues të komunës, ndërkaq theksoj se pastrimi i digave dhe ndalimi i ndërtimeve pa leje mbi diga të kontrollonte sasinë e ujit që derdhet mbi lumenj si dhe pengesat tjera që ngulfaten shtretërit e prrojeve etj. Kërkoj të di: A do te mund të iu dilni në ndihmë qytetarëve duke mbledhur të dhëna statistika dhe duke i dërguar në ministri. Familjet e prekura nga vërshimet a do të përfitojnë ndonjë ndihmë, kur do të bëhet kjo. A i shfrytëzoni mekanizmat të cilat i keni në dispozicion, si FSK etj. Kush do t'i siguroj qytetarët e komunës nëse ndodhë ndonjë reshje tjetër eventuale, apo do të pësojnë edhe me keq.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Unë nuk kujtoj se jemi vonuar në këtë drejtim.

**z. Selim Reka,** Komuna e Kaçanikut në bazë të pozitës që e ka, mund të priten gjendje emergjente në çdo çast nga reshjet atmosferike. Ne duhet mendojmë për hapat që duhet me i marrë në sanim të gjendjes. Komisioni i ka evidentuar shkaqet, por çështja ka ngecë, kështu propozoj të formohet një, Fond Emergjent, i cili fond të pasurohet në vazhdimësi edhe nga të HVK për me iu dalë në ndihmë qytetarëve në situata të tilla, ndërkaq shtoj se fond emergjent veç kanë disa nga komunat e Republikës së Kosovës.

**z. Ekrem Raka,** Nga Raporti finansiar shihet se shumë mjete kanë shkuar në rehabilitim të rrugëve etj. Propozoj që komuna për të ardhmen, të hartoj projekte për vendet ku parashihet se mund të ketë rrëshqitje, me qëllim të parandalimit të tyre në rast se ndodhin.

**z. Bekim Koxha,** Kur lumi Neredime po del nga shtrati për gjatë reshjeve atmosferike, po rrezikohen tokat bujqësore atypari, kështu duhet gjetur forma që, ndonjë investim për me marrë veprime për mbrojtjen e tokave bujqësore.

**z. Shpend Krusha,** Gjatë vërshimeve, unë bëra një vizitë në f. Kukaj dhe gjendja është keq, ka familje të rrezikuara. Me intereson të di, a ka komuna Shtab Emergjent, për intervenim të menjëhershëm, sepse pasojat janë të paparashikuara. Duhet me biseduar edhe me “Bektel Enken” sepse si rezultat i punimeve në autostradë, kjo kompani e ka ndryshuar rrjedhjen natyrore të lumenjve etj., ndërkaq nuk e di nëse komuna ka marrë ndonjë veprim a në këtë drejtim.

**Nënkryetari i Komunës,** Fondi emergjent është shumë i nevojshëm, sepse në rast rreziku është shumë vështirë mos me pasur mundësi me i dalë dikujt në ndihmë. Është mirë që çdo kush që ka ndonjë ide me ndihmuar në këtë drejtim, sepse ne shumë flasim, por nuk ndihmojmë me punë. Ne si komunë jemi munduar me marrë veprime tona brenda mundësive që kemi, shtab emergjent ekziston, udhëhiqet nga Kryetari i Komunës, jepni ju ndonjë ide apo mendim, kështu së bashku nuk mendoj se nuk do të përkrahët, por pa bërë politikë, sepse ekipi i jonë është angazhuar orar e pa orar, ne e kemi ngritur këtë çështje në MTI, i kanë marrë parasysh shqetësimet tona, një zëvendësministër ka qenë me vizituar komunën tonë për gjatë kohës së vërshimeve. Ne dihet se nuk mundemi me e paditur “Bektel Enken”, besoj se brenda muajit se bashku me inxhinierët tonë dhe me kompaninë në fjalë do të bëjmë diçka në këtë drejtim.

**znj. Kaltrina Tafili,** Në lagjen ku banoj unë, në kohën e vërvshimeve është zënë rruga, ndërkaq vet qytetarët e lagjes kanë ndihmuar në këtë drejtim.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në situata emergjente duhet me intervenuar komuna, por jo në çdo rast, ku ka rrëshqitje të 2-3 gurëve, atëherë duhet të vjen në shprehje vullnetarizmi.

**znj. Lirije Shurdhani,** Në f. Bob që dy muaj është mbyllur Përroi dhe ka vështirësuar qarkullimin kalimin e qytetarëve në atë pjesë, ndërkaq nuk është marrë ndonjë veprim për sanimin e gjendjes.

**z. Ramadush Osmani,** Jemi duke punuar në këtë drejtim, jemi duke bërë analiza për pjerrinat që parashihen se mund të rrëshqas.

**z. Bekim Koxha,** A do të iu bëhet kompensimi i dëmeve atyre familjeve që pësuan nga vërvshimet.

**z. Ramadush Osmani,** Në çështjen e ndërlidhur për dëmet nga reshjet atmosferike, theksoj se ende nuk kemi Raport nga Ministria, shpresa për kompensime të dëmeve ka e sidomos në f. Kuka. Raporti është në shqyrtim të ministrisë.

#### 10. Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Raka,** Të mbledhjet në periudhën, 16-23 prill, pika 2, duhet të jetë: Aktivitetet për dëmet e shkaktuara në prona publike dhe private e për gjatë ndërtimit të autostradës nga kompania” Bektel Enka”.

**z. Adnan Reka,** Unë shpresoj që KKS dhe mekanizmat tjera do të trajtojnë çështjen e ”Laurës”, nënkalimit hekurudhor që shpie të shkolla ‘Emin Duraku’ në Dushkajë, kërkesë kjo e LDK, e cila ndihet nevojë urgjente me marrë veprime të nevojshme për sigurinë e nxënësve dhe qytetarëve të tjera, sa nuk është bërë vonë.

Me vërejtjen e Ekrem Raka, ky Plan pune u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë.

#### VENDIM

**Për aprovimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2018.**

#### 11. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Kuvendit në ora: 13: 48 e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 25 anëtarë, ndërkaq me lejen e Kryesuesit të KK, me herët doli nga mbledhja. Hafize Sallabi

Procesmbajtës  
Makfîre Malsiu



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**nga Mbledhja e III (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin  
2018, mbajtur me 30 Mars 2018.**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili .....
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,